



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit/ Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca/ Office of the
Chief State Prosecutor**

A.nr.231/2016

Datë, 28.04.2016

Prishtinë

**Kryeprokurorëve dhe prokurorëve të prokurorive themelore në Prishtinë, Pejë, Prizren,
Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, dhe Ferizaj**

Ud / Kryeprokurorit dhe prokurorëve të Prokurorisë së Apelit - Prishtinë

**Ud / Kryeprokurorit dhe prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës -
Prishtinë**

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-034 mbi ndryshimin e Ligjit
për prokurorin e Shtetit Nr.03/L-225 nxjerr këtë:

U D H Ë Z I M

Lidhur më statusin e avokatëve

Në bazë të nenit **Neni 3 të Ligjit për avokatinë** - Avokatia është profesion i lirë dhe i pavarur
që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e
lirive, të drejtave dhe të interesave të tyre në pajtim me rendin juridik, ndërsa sipas nenit 5
paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të këtij ligji, **Avokat është personi që është i regjistruar në Odë, që e
ka dhënë betimin dhe merret me avokati.**

Në bazë të nenit 41 par. 3 të Ligjit për avokatinë – Oda e Avokatëve është organizatë profesionale e pavarur e avokateve me cilësinë e personit juridik e themeluar në pajtim me ligjin dhe Statutin e Odes, e cila është kompetente për ushtrimin e autorizimeve publike dhe kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm, në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Odes me autorizime publike me cilësi të personit juridik.

Në bazë të nenit 120 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Person zyrtar - nënkupton: personin e autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin, ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për avokatinë, si detyrë e posaçme e avokatit është parashikuar dhënia e ndihmës juridike, e cila përfshin:

- 1.1. dhënien e këshillave dhe mendimeve juridike;
- 1.2. hartimin e padive, kërkesave, propozimeve, lutjeve, mjeteve juridike dhe parashtrësive tjera;
- 1.3. hartimin e kontratave, marrëveshjeve, testamenteve, deklaratave, akteve të përgjithshme dhe të veçanta si dhe dokumenteve tjera;
- 1.4. përfaqësimin dhe mbrojtjen e personave fizikë dhe juridikë, shoqëritë afariste dhe subjektet tjera juridike para gjykatave dhe organet tjera shtetërore;
- 1.5. përfaqësimi i personave fizikë e juridikë në punët e tyre juridike, në zgjidhjen miqësore të kontesteve dhe raporteve kontestuese;
- 1.6. kryerjen e punëve tjera të ndihmës juridike në emër dhe për llogari të personave fizikë e juridikë vendorë apo të huaj, në bazë të të cilave realizohen të drejtat dhe mbrohen liritë dhe interesat tjerë.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit për avokatinë, i cili nen ka rregulluar çështjen e përgjegjësisë disiplinore të avokatëve dhe praktikantëve - Shkelje e rëndë konsiderohet edhe çdo shkelje e detyrës zyrtare, prestigjit dhe Kodit të etikës së avokatëve, e cila ka peshë më të rëndë për shkak të rëndësisë së të mirave të rrezikuara, natyrën e detyrës zyrtare të shkelur, lartësia e dëmit material ose pasojat tjera dhe duke marrë parasysh rrethanat, në të cilat është kryer apo nuk është kryer veprimi ndërsa - Shkelje të lehtë paraqet shkelja e detyrës zyrtare, prestigjit dhe Kodit të etikës së avokatëve me peshë më të vogël.

Në bazë të nenit Neni 342 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i cili rregullon përgjegjësinë e personit në rastin e keqpërdorimit të besimit, rezulton së:

1. Kushdo që gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t'i shkaktojë dëm personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Andaj duke u bazuar në dispozitat e sipër përmendura, nxjerr këtë

KONKLUZION

1. Avokati është person zyrtar çdo herë kur caktohet sipas detyrës zyrtare për të ushtruar detyrën e tij si avokat
2. Avokati gjithashtu është përgjegjës për veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 të KPRK gjatë përfaqësimit të palëve në çfarëdo procedure para gjykatës, prokurorisë, policisë ose organeve tjera administrative, nëse përmbushën elementet e kësaj vepre penale nga paragrafi i parë.
2. Ky udhëzim duhet të zbatohet nga të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët e të gjitha prokurorive në Kosovë



Tu dërgohet:

Të gjithë Kryeprokurorëve dhe prokurorëve të gjitha prokurorive në Kosovë